LIGJ
Nr. 36/2026

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR. 9710, DATË 10.4.2007, "PËR PORTET TURISTIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika l, të Kushtetutës, me propozim të një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9710, datë 10.4.2007, "Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas paragrafit të parë të nenit 6 të ligjit nr. 9710, datë 10.4.2007, "Për portet turistike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Kur një subjekti i është dhënë statusi "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë" nga Komiteti i Investimeve Strategjike dhe njëkohësisht porti/et turistik/e janë pjesë përbërëse e një investimi strategjik, të miratuar nga KIS-ja, ndërtimi dhe operimi i porteve turistike përjashtohet nga parashikimi i paragrafit të parë të këtij neni. Ndërtimi dhe operimi i portit/eve turistik/e kryhet nga subjekti që i është dhënë statusi "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë".

Procedurat, rregullat dhe dokumentacioni i nevojshëm për lidhjen e kontratës për ndërtimin dhe operimin e portit/eve turistike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 2
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor sipas nenit 1 të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.4.2026.

Shpallur me dekretin nr. 287, datë 7.5.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.